

20231792079

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT TË MARRËDHËNIEVE TË PUNËS

Neni 1

Në Ligjin e Marrëdhënieve të Punës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 62/2005, 106/2008, 161/2008, 114/2009, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15, 27/16, 120/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” numër 110/19, 267/20, 151/21 dhe 288/21), në nenin 110, pas paragrafit (3) shtohet paragraf i ri (4), i cili thotë:

“(4) Ministri i Financave, në pajtim me ministrin e Punës dhe të Politikës Sociale, e përcakton mënyrën dhe vendin e pagesës së pagave të punëtorëve, që punojnë në projekte me rëndësi strategjike nacionale, të përcaktuar me ligj”.

Neni 2

Pas nenit 117 shtohet nen i ri 117-a, i cili thotë:

“Neni 117-a

(1) Me përjashtim të nenit 117, paragrafët (1), (2) dhe (7) të këtij ligji, për punë në projekte me rëndësi strategjike nacionale të përcaktuar me ligj, ndërsa për shkak të nevojës për vazhdimësi të punës, puna jashtë orarit mund të zgjasë më gjatë se tetë orë në javë dhe 190 orë në vit, pas pëlqimit paraprak të dhënë me shkrim nga ana e punëtorit.

(2) Puna mbi 40 orë në javë llogaritet dhe paguhet si punë jashtë orarit, me respektim të detyrueshëm të dispozitave për pushim ditor dhe javor, në pajtim me nenet 133 dhe 134 të këtij ligji”.

Neni 3

Në nenin 134, paragrafi (3), në nënparagrafin 42), lidhëza “dhe” zëvendësohet me presje.

Në nënparagrafin 43), pika në fund të fjalisë zëvendësohet me lidhëzën “dhe” dhe shtohet nënparagrafi i ri 44), i cili thotë:

“- punon në projekte me rëndësi strategjike nacionale, të përcaktuar me ligj”.

Neni 4

Komisioni Juridik Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut autorizohet të përcaktojë tekst të konsoliduar të Ligjit të Marrëdhënieve të Punës.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.